



KONTRATE - SHITJE KUOTASH

(Bazuar ne nenin 705 e vijim te K.Civ.)

Ne Tirane, sot me date 13.01.1999 (Nentedhjete e nente), para meje Ilir Qejvani, noter ne Tirane, u paraqiten personalisht dhe me kerkuan redaktimin e kesaj kontrate shitje:

SHITESI: Aleksander Mitrush, i biri i Thomait, lindur me 1952, banues ne Tirane, R. "Dibres", Pall. 106, madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar, me pasaporte Nr. *certif. lundje 1133*.

BLERESI: Ferdinand Caushaj, i biri i Faikut, lindur me 1968, banues ne Tirane R. "V. Capo", Pall. 71, Sh. 1, Ap. 8, madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar, me pasaporte Nr. 1088754 dhe

Sokol Beshaj, i biri i Fatmirit, lindur me 1957, banues ne Tirane, Pallatet Moskate, madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar me pasaporte Nr. 0489704.

Shitesi Aleksander Mitrush eshte ortak i vetem dhe administrator i shoqerise tregtare "I N A", me Nr. Serial 019532 dhe Kod Fiskal ne certifikaten e rregjistrimit ne organin tatimor Nr. 3806478, si person juridik.

Me vendim te ortakut te vetem te kesaj shoqerie eshte vendosur largimi i tij nga kjo shoqeri dhe shitja e kuotes se kapitalit fillestar, dy bleresve te siper cituar, e konkretisht nga 50% secilit ortak te ri. Kjo kuote eshte 50.000 (Pesedhjetemije) leke te reja secili.

Edhe ortaket e rinj Ferdinand Caushaj dhe Sokol Beshaj jane dakort ta blejne kete kuote kapitali. Kapitali fillestar i shoqerise mbetet 100.000 (Njehqintemije) leke te reja.

Me nenshkrimin e kontrates se shitjes se kuotave ortaku qe ben shitjen xhvishet nga e drejta e pronesise mbi kete shoqeri e drejte kjo qe i kalon bleresve te mesiperm.

Kontrata, perpilohet ne tre kopje, ju lexohet paleve, kuptohet, dhe meqenese shpreh vullnetin e tyre te lire e te plote, nenshkruhet para meje dhe une noteri e vertetoj sipas ligjit.

*A. Cedevica*  
*Noter*

Ferdinand Caushaj  
*Caushaj*

BLERESI  
SOKOL BESHAJ  
*Beshaj*



NOTER  
Ilir Qejvani  
*Qejvani*